VENDIM
Nr. 29, datë 26.3.2012

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR
"TV KABLLOR MANASTIRI"
SUBJEKTIT: PERSONIT FIZIK ARBEN NAZËRAJ

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabllo", miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.3.2004 të KKRT-së, të ndryshuar, dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, personit fizik Arben Nazëraj për t'u licencuar si operator televiziv privat kabllor dhe mbështetur në propozimin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë licencë, subjektit personit fizik Arben Nazëraj, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat për "TV kabllor Manastiri", në fushën e transmetimeve televizive private kabllore për një periudhë prej 6 (gjashtë) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, në komunën Kolonjë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati